

## **BURSA SHQIPTARE E ENERGISJË ELEKTRIKE - ALPEX SHA**

### **VENDIM TEKNIK Nr. 1-C**

**Për**

**“Miratimin e Procedurave për Procesin e Aderimit të Anëtarit të Klerimit për Tregjet e ALPEX-it, përfundimit vullnetar të Anëtarit të Klerimit dhe çështje të tjera të lidhura me të”**

Në mbështetje të dispozitave të;

- I. Seksioneve C.1., C.2. të Kapitullit C, dhe F.3.1. të Kapitullit F për Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.
- II. Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme.

#### **ALPEX SHA Miratoi:**

1. Procedurën e procesit të Aderimit të Anëtarit të Klerimit për Tregjet e ALPEX-it, F.3.1.7 përfundimi vullnetar i Anëtarit të Klerimit dhe çështje të tjera të lidhura me të.
2. Vendimi Teknik Nr.1-C i paraqitet për njoftim Entit Rregullator të Energjisë – ERE / Zyrës së Rregullatorit për Energji - ZRrE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ADMINISTRATORI I ALPEX SHA**

**Sokol Dishnica**

## VENDIM TEKNIK Nr. 1-C

### NENI 1

#### 1. QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI

Ky Vendim Teknik përcakton çështjet në lidhje me Anëtarët e Klerimit të ALPEX-it si më mëposhtë:

1. Procedura në lidhje me procesin e aderimit të Anëtarit të Klerimit
2. Procedura në lidhje me përfundimin vullnetar nga statusi si Anëtar Klerimi
3. Procedura e aplikuar në rastet e transformimeve korporative të një Anëtari Klerimi
4. Procedura për zhvendosjen e infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit (TI) të Anëtarit të Klerimit

Kushtet dhe përkufizimet e përdorura në këtë Vendim Teknik kanë të njëjtin kuptim me të dhënat në shpjegimet e Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme, Përkufizimet e rregullave të tregut të energjisë elektrike dhe në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes, si dhe në çdo vendim tjetër të miratuar për zbatimin e tyre, përveç nëse parashikohet shprehimisht ndryshe.

Në çdo rast, parashikimet e këtij Vendimi Teknik interpretohen në përputhje me rregullat dhe parimet e parashikuara në Fushëveprimin e Zbatimit të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.

Referimi i termit "Tregu" ose "Tregjet", nënkupton, përveç nëse parashikohet shprehimisht ndryshe, Tregjet e ALPEX-it.

Kur tek ky Vendim Teknik referimi i termit Anëtarë Klerimi, nënkupton, përveç nëse parashikohet shprehimisht ndryshe, Anëtarët e Klerimit të cilët marrin pjesë në Klerimin e Transaksioneve ose Pozicioneve të tregut të mësipërm.

Referimi i termit "Klerim", nënkupton, përveç nëse parashikohet shprehimisht ndryshe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes.

### NENI 2

#### 2. PROCEDURA E PROCESIT TË ADERIMIT TË ANËTARIT TË KLERIMIT

##### 2.1 Procedura dhe Fazat për vlerësimin dhe pranimin e një Anëtari Klerimi

- (a) Në mënyrë që të plotësojë kushtet për të marr statusin e Anëtarit të Klerimit, Aplikanti duhet të ndjekë në mënyrë rigoroze dhe të përmbyllë me sukses procedurën e parashikuar në këtë Nen e cila përfshin tre (3) fazat e mëposhtme, përkatësisht:

- (i) faza e dorëzimit të “Aplikimit” sipas Procesit të Aderimit për të marr statusin e Anëtarit të Klerimit dhe miratimin përkatës të tij dhe nënshkrimin e Marrëveshjes Kuadër për Klerim;
  - (ii) faza përgatitore për aktivizimin e Anëtarit të Klerimit në Sistemin e Klerimit të Tregut të Energjisë; dhe
  - (iii) faza e aktivizimit të Anëtarit të Klerimit në Sistemin e Klerimit të Tregut të Energjisë.
- (b) ALPEX informon Aplikantin për fazat e procedurës dhe jep çdo informacion dhe të dhëna të nevojshme për pjesëmarrjen e tij në këto faza. Pjesëmarrja e Aplikantit në çdo fazë pasuese të Procedurës presupozon përfundimin me sukses të fazës pararendëse.

### **2.1.1 Faza e Parë: Paraqitja e Aplikimit për Procesin e Aderimit të Anëtarit të Klerimit dhe miratimin e tij.**

Kjo fazë përfshin dorëzimin e Aplikimit pranë ALPEX-it me qëllim marrjen e statusit të Anëtarit të Klerimit dhe nënshkrimin e Marrëveshjes Kuadër për Klerim.

#### **2.1.1.1 Kushtet e Përgjithshme**

- (a) Aplikanti plotëson dhe dorëzon aplikimin, duke përdorur formularin tip i siguruar nga ALPEX. Formulari i aplikimit shoqërohet me një formular standard “si të njohësh klientin tënd”, i cili sigurohet nga ALPEX-i.
- (b) Në Aplikim është përcaktuar lloji i Anëtarit të Klerimit (Personal ose i Përgjithshëm).
- (c) Aplikimi duhet të shoqërohet gjithashtu me dokumentet mbështetëse sic janë të përshkruar në seksionin 2.1.1.2 dhe 2.1.1.3.
- (d) Të gjitha dokumentet mbështetëse duhet të dorëzohen në Shqip ose Anglisht. Të gjitha dokumentet duhet të mbajnë vulën e kompanisë, dhe duhet të dorëzohen në origjinal ose kopje të noterizuar nga origjinali.
- (e) Gjatë shqyrtimit të informacionit të mëposhtëm si dhe dokumentacionit mbështetës të dorëzuar nga Aplikanti në të gjitha fazat e përshkruara më poshtë, ALPEX-i mund të kërkojë dokumente shtesë nëse e gjykon të nevojshme për plotësimin e aplikimit.

#### **2.1.1.2 Anëtar Personal i Klerimit**

Nëse Aplikanti është duke aplikuar për marrjen e statusit si Anëtar Personal Klerimi në përputhje me paragrafin C.1.2.1 në seksionin C.1.2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes të Tregjeve të ALPEX-it, duhet të paraqesë:

- (a) Aplikimin për marrjen e statusit si Anëtar Personal të Klerimi.
- (b) Detajet dhe dokumentet mbështetëse të ofruara për Anëtarët e Bursës që janë Entitete të pranueshëm në përputhje me;
  - (i) kapitullin C të Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme, për pjesëmarrjen në Tregjet e ALPEX-it.
  - (ii) Vendimin teknik Nr.1-T.
- (c) Pasqyrat financiare ose të dhënat e dy (2) viteve të fundit që vërtetojnë se Aplikanti plotëson para-kushtet financiare të përcaktuara në seksionin C.2.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes. Në rastin e një entiteti të sapo krijuar, të dhënat financiare që vërtetojnë përmbushjen e kërkesave të sipërpërmendura.
- (d) Nëse ndonjë nga dokumentet e mësipërme mbështetëse janë dorëzuar tashmë në ALPEX, ato nuk kërkohen të ridorëzohen.

### **2.1.1.3 Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit**

Nëse Aplikanti është duke aplikuar për marrjen e statusit si Anëtar i Përgjithshëm Klerimi në përputhje me paragrafin C.1.3.1 në seksionin C.1.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, duhet të paraqesë:

- (f) Aplikimin për marrjen e statusit si Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit dhe një formular standard "si të njohësh klientin tënd".
- (g) Një kopje të noterizuar të licensës për operim të lëshuar nga Banka e Shqipërisë / Banka e Kosovës.
- (h) Ekstrakti / Informatat e Biznesit i vlefshëm i nxjerrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) / Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK).
- (i) Pasqyrat financiare ose të dhënat e dy (2) viteve të fundit që vërtetojnë se Anëtari i ardhshëm i Klerimit plotëson para-kushtet financiare të përcaktuara në seksionin C.2.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes. Në rastin e një entiteti të sapo krijuar, të dhënat financiare që vërtetojnë përmbushjen e kërkesave të sipërpërmendura.
- (j) Nëse ndonjë nga dokumentet mbështetëse të mësipërme të paragrafeve (a) deri (d) është dorëzuar tashmë në ALPEX, këto nuk kërkohen të ridorëzohen. Nëse informacioni i kërkuar nuk plotësohet ALPEX brenda 10 (dhjetë) ditëve, do të konsiderohet se Aplikimi është tërhequr.

#### **2.1.1.4 Vlerësimi i aplikimit**

Pas paraqitjes së detajeve të mësipërme dhe dokumenteve mbështetëse, ALPEX vendos mbi Aplikimin për marrjen e Aderimit të Anëtarit të Klerimit.

ALPEX miraton ose refuzon kërkesën e Anëtarit të ardhshëm të Klerimit në bazë të një vendimi të arsyetuar dhe e njofton atë për këtë vendim, brenda afatit të parashikuar në paragrafin C.2.1.13 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.

Nëse aplikimi miratohet, ALPEX-i i jep Anëtarit të Klerimit një deklaratë që vërteton marrjen e statusit të Anëtarit të Klerimit, i cili duhet të;

- (a) Dorëzojë kopjen e pagesës që dëshmon depozitimin e Tarifës Fikse të Aderimit dhe Tarifën Fikse Vjetore dhe tarifave të tjera në varësi të faktit nëse kërkohet sipas statusit për Anëtar Personal Klerimi apo Anëtar i Përgjithshëm Klerimi, të specifikuara në Listën e Tarifave të ALPEX, të publikuar në faqen internetit të ALPEX-it
- (b) Aplikanti duhet ta dorëzojë Marrëveshjen Kuadër për Klerim të nënshkruar brenda 30 ditëve nga dita e marrjes.

Me marrjen e statusit si Anëtar Klerimi ndiqen hapat e përshkruara në Fazën e dytë.

#### **2.1.2 Faza e Dytë: Përgatitja për Aktivizimin e Anëtarit të Klerimit në Sistemin e Klerimit të Tregut të Energjisë**

Faza e dytë fillon ditën tjetër të punës pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Kuadër të Klerimit dhe Anëtari i Klerimit duhet të ndjekë hapat e mëposhtme:

- (a) Anëtari i Klerimit duhet të ketë infrastrukturën e nevojshme teknike për të siguruar ndërlidhjen e tij të suksesshme me Sistemi i Klerimit të Tregut të Energjisë (këtu e në vazhdim “EMCS”), në përputhje me dispozitat e Vendimeve përkatëse si dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme dhe në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes.
- (b) Anëtari i Klerimit duhet të ketë një numër të mjaftueshëm Agjentësh Klerues të Certifikuar, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes, ashtu si dhe Vendimet përkatëse të nxjerra në zbatim të tyre.
- (c) Në mënyrë që të vlerësojë gatishmërinë e Anëtarit të ardhshëm të Klerimit dhe Agjentët e tij Klerues të Certifikuar, ALPEX mund të kërkojë pjesëmarrjen e tij në seanca testimi dhe provimi ose seanca të tjera simuluese të kushteve reale të klerimit dhe shlyerjes.

Anëtari i Klerimit duhet të ketë përfunduar veprimet e mësipërme jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të Fazës së Parë, duke mos marrë parasysh kohën e përgatitjes së infrastrukturës teknike. Përndryshe, aplikimi e tij do të refuzohet për shkak të mos përfundimit të fazës së dytë, dhe për marrjen e statusit përkatës, Aplikanti duhet të riparaqesë Aplikimin.

### **2.1.3 Faza e Tretë: Aktivizimi i Anëtarit të Klerimit në EMCS**

#### **2.1.3.1 Dokumentet e nevojshme mbështetëse**

Për t'u aktivizuar në EMCS, Anëtari i Klerimit duhet fillimisht të depozitojë Kontributin Fillestar në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve për statusin përkatës të Anëtarit të Klerimit, siç specifikohet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes dhe të dorëzojë në ALPEX dokumentet mbështetëse të mëposhtme;

- (a) Nëse aplikimi ka të bëjë me një Anëtar Personal Klerimi, duhet të dorëzojë një vërtetim për regjistrimin si Anëtar Burse.
- (b) Formularin "Të dhënat e kontaktit të Anëtarit të Klerimit". Duke përdorur këtë formular Anëtari i Klerimit është i detyruar të deklarojë personat që do të jenë përgjegjës për komunikimin e tij me ALPEX-in dhe/ose Agjentët Klerues të Certifikuar, të dhënat e kontaktit të personave të sipërpërmendur si dhe detyrat e secilit person pranë Anëtarit të Klerimit.
- (c) Formularin "Aplikimi për Aktivizimin/Përfundimin Vullnetar". Me këtë formular, Anëtari i Klerimit deklaron datat në të cilat dëshiron të aktivizohet ose dorëhiqet si Anëtar Klerimi.
- (d) Formularin "Aplikimi i Menaxhimit të Përdoruesve në Sistem". Me këtë formular Anëtari i Klerimit kërkon aktivizimin dhe çaktivizimin e përdoruesve në EMCS si dhe mënyrën e lidhjes.
- (e) Aplikimin për aktivizimin e një Llogarie Personale Klerimi, siç specifikohet në varësi të statuseve të sipërpërmendura që kërkohen dhe dispozitave specifike të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes. Aplikimi dorëzohet me anë të formularit standard i cili ofrohet nga ALPEX.
- (f) Deklaratë me shkrim për konfirmimin dhe pranimin që ALPEX ka të drejtë të përdorë garancitë financiare dhe kontributet në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve. ALPEX siguron formën standarte të "Konfirmimit dhe Pranimit të Kushteve për të drejtën e ALPEX për të përdorur Garancinë dhe kontributet në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve"
- (g) Detajet e Llogarisë bankare për Shlyerje në Bankën për Shlyerje, siç specifikohet në Vendimet Teknike përkatëse ose në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes.

Jo më vonë se pesë (5) ditë përpara aktivizimit të tij, Anëtari i Klerimit duhet të ketë përfunduar të gjitha hapat e mësipërme dhe të dorëzojë në ALPEX të gjitha dokumentet mbështetëse të sipërpërmendura të kërkuara për aktivizimin e tij.

Me aktivizimin e një Anëtari Klerimi, ALPEX do të përditësojë menjëherë bazën e tij elektronike të të dhënave të Anëtarëve të Klerimit dhe faqen zyrtare të internetit me të dhënat e këtij Anëtari Klerimi. Gjithashtu, do të njoftojë Bankën për Shlyerje.

### **2.1.3.2 Njoftimi në ALPEX**

- (a) Anëtari i Klerimit duhet të njoftojë, në mënyrë të menjëhershme ALPEX-in, në lidhje me çdo ndryshim që ka të bëjë me detajet e kontaktit të tij ose të dhënat e Agjentit Klerues të Certifikuar që kanë akses në EMCS. Deri në njoftimin e një ndryshimi të tillë, të gjitha dokumentet do të dorëzohen në mënyrë të ligjshme në adresën e dhënë nga Anëtari i Klerimit në fazën e paraqitjes së aplikimit.
- (b) Anëtari i Klerimit është i detyruar të paraqesë të dhënat dhe dokumentet përkatëse si hap i parë nëpërmjet e-mailit (kopje të skanuar të dokumenteve origjinale ose të noterizuara), në mënyrë që të vlerësohet nga ALPEX. Në çdo rast, aplikanti duhet të dorëzojë fizikisht kopjen, ose dokumentet origjinale/të noterizuara, përpara nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër për Klerim nga të dyja palët. Anëtarët e Klerimit do të jenë ekskluzivisht përgjegjës për plotësinë, korrektesinë dhe vërtetësinë e të dhënave/dokumentave që ata i japin ALPEX, si për të dhënat/dokumentet e dorëzuara në fillim, ashtu edhe për të dhënat/dokumentave që janë përditësuar në çdo kohë. Anëtari i Klerimit duhet t'i përgjigjet menjëherë dhe pa hezitim çdo kërkesë të ALPEX, duke marrë pjesë në çdo takim përkatës, si edhe kërkesa të tjera nga ALPEX.

## **NENI 3**

### **3. PROCEDURA E PËRFUNDIMIT VULLNETAR NGA STATUSI I ANËTARIT TË KLERIMIT**

#### **3.1 Dokumentet e kërkuara mbështetëse**

##### **3.1.1 Përfundimi vullnetar nga statusi si Anëtar Klerimi**

Për tu dorëhequr nga statusi si Anëtar Klerimi, përveç kërkesave të përcaktuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes, Anëtari i Klerimit duhet:

- (a) Të marrë të gjitha masat e nevojshme për të rregulluar, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes, çdo çështje me pagesat që rrjedhin nga Transaksionet dhe pozicionet që kanë përfunduar.
- (b) Të zbatojë udhëzimet e ALPEX për shlyerjen përfundimtare të çdo shume të papaguar në lidhje me statusin e tij.

- (c) Të paraqesë një aplikim për çaktivizimin e Llogarisë Personale të Klerimit ose të Llogarive të Klerimit të Anëtarëve të Bursës, në varësi të statusit që kishin marrë dhe në përputhje me dispozitat më specifike të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes. Ky aplikim dorëzohet me anë të formularit standard i cili ofrohet nga ALPEX.

Garancia në Llogaritë e Klerimit të Anëtarëve të Klerimit që po dorëhiqet kthehet menjëherë pas shlyerjes së plotë të të gjitha detyrimeve të tij kundrejt ALPEX-it. Gjendja e Pjesës Proporcionale të Anëtarit të Klerimit në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve kthehet pasi të jetë miratuar dhe lëshuar urdhri i pëlqimit për Përfundimin Vullnetar nga ALPEX, miratim i të cilit do të jepet me kusht që të gjitha detyrimet e tij kundrejt ALPEX të jenë përmbushur plotësisht në përputhje gjithashtu me dispozitat specifike në Kapitullin F.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes për transaksionet në Tregjet e ALPEX. Pas përfundimit vullnetar të Anëtarit të Klerimit, ALPEX-i do të përditësojë menjëherë bazën e të dhënave elektronike të Anëtarëve të Klerimit në faqen zyrtare të internetit dhe do të njoftojë Bankën për Shlyerje.

#### NENI 4

### **4. PROCEDURA E TRANSFORMIMIT TË KORPORATËS TË ANËTARËVE TË KLERIMIT**

#### **4.1 Bashkimi i një Anëtari Klerimi nëpërmjet përthithjes nga një Anëtar tjetër Klerimi**

Parashikimet e përcaktuara në këtë paragraf 4.1 do të zbatohen vetëm kur përthithësi ashtu edhe i përthithuri janë Anëtarë Klerimi.

Zbatimi i kushteve të këtij neni kërkon që Anëtarët e Klerimit të përfshirë të jenë përkatësisht Anëtarë Personalë Klerimi ose Anëtarë të Përgjithshëm Klerimi. Në të kundërt, transformimi i korporatës do të shqyrtohet rast pas rasti nga ALPEX në kuadër të dispozitave në fuqi të sektorit të energjisë dhe atij financiar në kombinim me kushtet e këtij neni.

##### **4.1.1 Veprimet e Anëtarit të Klerimit përthithës**

Në rastin e bashkimit të një Anëtari Personal Klerimi ose një Anëtari të Përgjithshëm Klerimi, nëpërmjet përthithjes së tij nga një Anëtar tjetër Personal Klerimi ose Anëtar tjetër i Përgjithshëm Klerimi, Anëtari i Klerimit përthithës vazhdon të veprojë si një Anëtar Klerimi, dhe automatikisht do të marr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Anëtarit të Klerimit të përthithur. Në një rast të tillë, Anëtari të Klerimit përthithës nuk i kërkohet të marrë sërish statusin e Anëtarit të Klerimit.

Anëtari i Klerimit përthithës duhet të respektojë procedurat e mëposhtme në lidhje me instalimin e infrastrukturës së TI-së dhe aktivizimin e tij në EMCS, e cila përbëhet nga dy (2) fazat e mëposhtme:



#### **4.1.1.1 Faza e parë**

Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë përpara datës së deklaruar nga Anëtari i Klerimit në të cilin ai dëshiron të aktivizohet në EMCS me të dhënat e tij të reja që rrjedhin nga bashkimi dhe me kusht që bashkimi të ketë përfunduar (d.m.th. paraqitjen e një ekstrati të vlefshëm nga regjistri tregtar i atij vendi), Anëtari i Klerimit përthithës i dërgon një njoftim me shkrim me detajet e bashkimit përkatës ALPEX-it dhe bashkëpunon me këtë të fundit në lidhje me:

- (a) Planifikimin e çdo ndryshimi në infrastrukturën e TI-së së Anëtarit të Klerimit përthithës,
- (b) Llogaritjen e kostove përkatëse dhe
- (c) Planifikimin e afatit kohor për kryerjen e veprimeve të nevojshme të mësipërme.

#### **4.1.1.2 Faza e dytë**

Jo më vonë se njëzet (20) ditë përpara datës së deklaruar për aktivizimin e Anëtarit të Klerimit në EMCS, Anëtari i Klerimit përthithës duhet të ketë përfunduar përgatitjet e nevojshme teknike në përputhje me udhëzimet e ALPEX-it dhe t'i dërgojë ALPEX-it një formular të plotësuar me të dhënat e reja të Anëtarit të Klerimit që rrjedhin nga bashkimi. Formulari i mësipërm është i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit të ALPEX.

### **4.1.2 Veprimet për fshirjen e Anëtarit të Klerimit të përthithur**

Veprimet që duhet të ndjekë Anëtari i Klerimit të përthithur, përfshijnë ndjekjen e tre (3) fazave të mëposhtme:

#### **4.1.2.1 Faza e parë**

Jo më vonë se njëzet (20) ditë përpara datës së deklaruar nga Anëtari i Klerimit përthithës i cili dëshiron të aktivizohet në EMCS me detajet e tij të reja të cilat rezultojnë nga bashkimi dhe me kusht që bashkimi të ketë përfunduar, Anëtari i Klerimit të përthithur duhet të paraqesë në mënyrë elektronike në ALPEX, formularët e mëposhtëm të publikuar në faqen zyrtare të internetit të ALPEX-it:

- (a) Për fshirjen e përdoruesve, të kërkesave për çaktivizim dhe
- (b) Fshirjen e Anëtarit të Klerimit të përthithur.

#### **4.1.2.2 Faza e dytë**

Fshirja e një Anëtarit Klerimi për shkak të bashkimit miratohet nga ALPEX-i me kusht që bashkimi të ketë përfunduar dhe të paraqesë një ekstrakt / informata te biznesit të vlefshëm nga regjistri tregtar.

#### **4.1.2.3 Faza e tretë**

- (a) Përfundimi i bashkimit kërkon sa vijon:
- (i) shlyerjen e të gjithë pagesave të mundshme nga Anëtari i Klerimit të përthithur që lindin nga transaksionet e përfunduara ose të caktuara nga pozicionet e hapura për të.
  - (ii) ndryshimet ose transferimet tek Anëtari i Klerimit përthithës i garancisë së dhënë nga Anëtari i Klerimit të përthithur.
  - (iii) çaktivizimi i Pjesës Propocionale të Anëtarit të Klerimit të përthithur në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve.
  - (iv) çaktivizimi i Llogarisë bankare për Shlyerje në Bankën për Shlyerje siç përcaktohet nga ALPEX në përputhje me procedurat e tij.
  - (v) pagesën e kontributeve shtesë në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve sa herë që kërkohet në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes.
- (b) Pas miratimit të bashkimit nga ALPEX-i dhe pas përfundimit të procedurave të përshkruara më sipër, çdo garanci e depozituar ose lëshuar në favor të ALPEX-it nga Anëtari i Klerimit të përthithur kthehet së bashku me kontributet në Fondin e Mospërbushjes së Detyrimeve, pa paragjykuar dispozitat specifike të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes për mbajtjen ose përdorimin e përkohshëm të tyre për shkak të Mospërbushjes së Detyrimeve.
- (c) Pas përfundimit të bashkimit, ALPEX-i do të përditësojë menjëherë bazën e tij elektronike të të dhënave të Anëtarëve të Klerimit dhe faqen zyrtare të internetit me detajet e reja të Anëtarit të Klerimit përthithës pas bashkimit dhe do të njoftojë Bankën për Shlyerje.

## **4.2 Bashkimi i një Anëtari Klerimi nëpërmjet përthithjes nga një entitet që nuk është një Anëtar Klerimi**

### **4.2.1 Veprimet e entitetit që përthith një Anëtar Klerimi në mënyrë për të marrë statusin e Anëtarit të Klerimit**

#### **4.2.1.1 Procedura në lidhje me statusin e Anëtarit Klerimit**

- (a) Në rastin e bashkimit të një Anëtari Klerimi me një entitet që nuk është Anëtar Klerimi, entiteti që lind nga ky bashkim duhet të marrë statusin e Anëtarit të Klerimit të këtij Anëtari Klerimi të përthithur dhe të ndjekë – që nga fillimi – procedurën e marrjes së statusit përkatës, duke përfshirë detyrimet e tij në lidhje me pagimin e Tarifës Fikse të Aderimit dhe/ose Tarifës Fikse Vjetore, në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike -

Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, këtë Vendim Teknik të ALPEX-it dhe Listës së tarifave të ALPEX.

- (b) Vendimi për miratimin e Anëtarit të ri të Klerimit, i cili merret nga ALPEX-i, me kusht që bashkimi të ketë përfunduar dhe të paraqesë një ekstrat të vlefshëm nga regjistri tregtar të atij vendi.

#### **4.2.2 Veprimet e Anëtarit të Klerimit përthithës**

- (a) Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë përpara datës së deklaruar nga Anëtari i Klerimit të përthithur për përfundimin e bashkimit (d.m.th të paraqesë një ekstrakt / informata biznesi të vlefshëm nga regjistri tregtar i atij vendi), Anëtari i Klerimit përthithës i dërgon ALPEX një letër njoftimi me detajet e bashkimit dhe bashkëpunon me këtë të fundit në lidhje me:
  - (i) Planifikimin e çdo ndryshimi në infrastrukturën e TI-së së entitetit përthithës (nyjet, терминаlet, etj.),
  - (ii) Llogaritjen e kostove përkatëse, dhe
  - (iii) Planifikimin e afatit kohor për kryerjen e veprimeve të nevojshme të mësipërme.
- (b) Anëtari Klerimit i përthithur duhet të ndërmarrë veprimet e parashikuara në nenin 2 të këtij Vendimi Teknik (Procedura Përfundimi Vullnetar).

#### **4.2.3 Aktivizimi në EMCS i Anëtarit të ri të Klerimit që rezulton nga bashkimi**

- (a) Aktivizimi në EMCS i Anëtarit të ri të Klerimit që rrjedh nga bashkimi realizohet në datën e përcaktuar në formularin standard përkatës, i cili gjendet në faqen e zyrtare të internetit të ALPEX-it, dhe me kusht që fazat e mëparshme të bashkimit të kenë përfunduar.
- (b) Pas përfundimit të bashkimit, ALPEX-i do të përditësojë menjëherë bazën e tij elektronike të të dhënave të Anëtarëve të Klerimit dhe faqen zyrtare të internetit me detajet e reja të Anëtarit të Klerimit përthithës pas bashkimit dhe do të njoftojë Bankën për Shlyerje.

#### **4.3 Transformime të tjera të korporatës**

- (a) Kushtet e paragrafëve të mësipërme të nenit 4 zbatohen si raste të ngjashme (mutatis mutandis) edhe për çdo rast tjetër të transformimit të korporatës që përfshin Anëtarët e Klerimit të ALPEX në përputhje me dispozitat e zbatueshme në mënyrë specifike të Ligjit 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, datë 14.04.2008, i amenduar / Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare të Republikës së Kosovës.

- (b) Në të gjitha rastet kur, si pasojë e një transformimi të korporatës, licenca mbi bazën e së cilës Anëtari i Klerimit ka marr statusin e tij kërkon një ndryshim nga Autoriteti Kompetent sipas kuadrit rregullator në fuqi. Anëtari i Klerimit duhet të njoftojë ALPEX-in me shkrim, përpara fillimit të procesit të transformimit të korporatës, në mënyrë që ALPEX të rivlerësojë statusin e Anëtarit të Klerimit.
- (c) ALPEX-i mund të pezullojë statusin e Anëtarit të Klerimit në përputhje me seksionin F.2.5 të Kapitullit F të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes për Transaksionet në Tregjet e ALPEX, deri në dhënien e licencës së ndryshuar.

## NENI 5

### **5. ZHVENDOSJA E INFRASTRUKTURËS SË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT TË ANËTARËVE TË KLERIMIT**

Në rastin e zhvendosjes së infrastrukturës së Teknologjisë dhe Informacionit (TI) të Anëtarëve të Klerimit të cilët janë të lidhur me sistemin e ALPEX-it, në ambiente të tjera, në të njëjtën adresë apo adresë tjetër, Anëtari i Klerimit duhet të ndjekë hapat e fazave më poshtë;

#### **5.1 Faza e parë**

Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë përpara datës së deklaruar nga Anëtari i Klerimit i cili dëshiron zhvendosjen e infrastrukturës TI në ambientet e reja, Anëtari i Klerimit dërgon një letër njoftimi në ALPEX me detajet e ambientit ku do të zhvendoset dhe bashkëpunon me këtë të fundit për:

- (a) Planifikimin e çdo ndryshimi në infrastrukturën e TI-së së Anëtarit të Klerimit,
- (b) Llogaritjen e kostove përkatëse, dhe
- (c) Planifikimin e afatit kohor për kryerjen e veprimeve të nevojshme të mësipërme.

#### **5.2 Faza e dytë**

Jo më vonë se njëzet (20) ditë para afatit të deklaruar për funksionimin e infrastrukturës së tij të TI në ambientet e reja, Anëtari i Klerimit duhet të ketë kryer përgatitjet e nevojshme teknike sipas udhëzimeve të ALPEX-it dhe të ketë dorëzuar në mënyrë elektronike në ALPEX formularin standard përkatës, i cili është i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit të ALPEX, për zhvendosjen e Anëtarit të Klerimit.

## NENI 6

### **6. HYRJA NË FUQI**

Ky Vendim Teknik hyn në fuqi që nga data 07/09/2023.

Ky Vendim Teknik do të publikohet në faqen zyrtare të internetit [www.alpex.al](http://www.alpex.al)